

SHQIPËRIA DHE EURO

---

**Domenico Mario Nuti**

**Profesor në Shkollën e Biznesit të Londrës dhe në  
Universitetin “La Sapienza” të Romës**

## **HYRJE**

Në qershor të vitit 2001, Komisioni European rekomandoi që të fillojnë bisedimet me Shqipërinë mbi “Paktin e Stabilizim-Asocimit”. Këshilli European ftoi Komisionin European të paraqiste një projekt mbi udhëzimet e bisedimeve; pas marrjes së miratimit nga Këshilli

European, bisedimet duhet të fillojnë në pranverë të vitit 2002. Pakti i Asocimit është hapi i parë në rrugën e gjatë të anëtarësimit në Bashkimin European, nëse Shqipëria vendos ta zbatojë.

Në anën tjetër, për të gjitha shtetet e reja anëtare, hyrja në Bashkimin European kërkon anëtarësimin në Bashkimin Monetar European – pas një pjesëmarrjeje dyvjeçare në Mekanizmin e Kursit të Këmbimit II (MKK – II)<sup>18</sup> dhe përmbushjen e kushteve të Maastricht për konvergjenca<sup>19</sup> monetare dhe fiskale. Të parat midis dhjetë vendeve europiano-qendrore që janë kandidatë për praninë në Bashkimin European<sup>20</sup> (përfshi Maltën dhe Qipron) priten të futen në Bashkimin European rreth vitit 2006, dhe në Bashkimin Monetar European rreth vitit 2008; parimisht, Shqipëria mund të jetë në gjendje të futet në Bashkimin European në vitin 2008 dhe në euro në vitin 2010.

Shpresa për të marrë pjesë në Europë në një të ardhme jo shumë të largët, është një arritje e madhe. Në vitin 1991, kur filloi procesin e tranzicionit, Shqipëria filloi nga kushtet më të papërshtatshme në të gjithë Europën Lindore Qendrore; ishte krejtësisht e izoluar pasi shkëputi marrëdhëniet si me Bashkimin Sovjetik ashtu edhe me Kinën, kishte një ekonomi plani të centralizuar të rreptë dhe të pareformuar, despotizëm dhe realisht nuk ekzistonte prona private. Në vitet 1989-92, Shqipëria humbi mbi 40 për qind të PBB-së së saj, por më pas, rritja ekonomike e pandërprerë dhe e qëndrueshme – me përjashtim të vitit 1997, kur PBB ra me 7 për qind – e bëri Shqipërinë një nga pak vendet në tranzicion, që në vitin 2000 tejkaloi nivelin e vitit 1989 (me 3 për qind). Shqipëria u bë anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë në shtator të vitit 2000; regjimi i saj i tregtisë së hapur kategorizohet në nivelin e parë nga dhjetë nivelet e tregjesit të tregtimit, të përcaktuar nga

---

<sup>18</sup> Nga 1/1/1999 MKK e udhëhequr nga Traktati i Maastricht, u zëvendësua me MKK – II, me të njëjtën luhatje +/- 15 për qind, por duke përfshirë kritere të tjera si zhvillimi i integritit të tregut, balancimi i llogarisë korente, monitorimi i njësisë së kostove të klasës punëtore dhe tregues të tjerë çmimesh.

<sup>19</sup> Këto janë 1) një normë mesatare e inflacionit në vitin e fundit, që të mos e kalojë më shumë se 1.5 për qind mesataren e tre vendeve anëtare me performancë më të mirë; 2) një mesatare të normës nominale të interesit afatgjatë mbi letrat me vlerë të qeverisë, për të njëjtën periudhë, që të mos e kalojë më shumë se dy pikë mesataren e tre shteteve të lartpërmendura; 3) një deficit qeveritar deri në 3 për qind të PBB-së dhe 4) një borxh qeveritar deri në 60 për qind të PBB – vetëm nëse këto raporte janë afër vlerave të përmendura dhe ose kanë rënë ndjeshëm tashmë, ose e kanë kaluar vlerën e përmendur vetëm përkohësisht.

<sup>20</sup> Këto janë të ashtuquajturit grupi i Luksenburgut: Hungaria, Polonia, Republika Çeke, Sllovenia, Estonia; plus i ashtuquajturit grupi i Helsinkit: Sllovakia, Letonia, Lituania, Bullgaria dhe Rumania.

Fondi Monetar Ndërkombëtar. Inflacioni, fillimisht në një klasifikim treshifror, pothuajse u ul në zero në vitin 1999 dhe nuk ka lëvizur që atëherë. Çekuilibrimet e brendshme dhe të jashtme janë akoma të pranishme, por kanë rënë dukshëm. Ndryshimet sistemike dhe strukturale kanë filluar. Në qershor të vitit 2001, Fondi Monetar Ndërkombëtar duke shqyrtuar programin për Uljen e Varfërisë në Shqipëri dhe Aftësitë për Zhvillim (UVAZ), përgëzoi rezultatet e arritura:

*“Drejtimi i shëndoshë makroekonomik dhe zbatimi i reformave strukturore janë rezultat i zhvillimit të vazhdueshëm dhe të qëndrueshmërisë financiare në Shqipëri. PBB po rritet me më shumë se 7 për qind dhe inflacioni nuk është rritur.*

*Politika fiskale është e qëndrueshme, e mbështetur nga përmirësimet e vazhdueshme në grumbullimin e të ardhurave vjetore. Një politikë monetare e kujdesshme, e vënë në zbatim kohët e fundit, nëpërmjet dokumenteve ligjore indirekte, ka për qëllim të mbajë inflacionin brenda kufijve 2-4 për qind.*

*Axhenda e privatizimit po i afrohet fundit, dhe ndiqet me njoftimin e fundit të tenderit të privatizimit të Bankës së Kursimeve. Politika e ndjekur nga autoritetet për vitin 2001 përfshin reforma të guximshme në sektorin e energjitikës, në mënyrë që të eliminohet ndërprerja e elektricitetit që mund të kërcënojë perspektivën e rritjes ekonomike. Efikasiteti dhe qeverisja e administrimit të të ardhurave vjetore po forcohen, bazuar në përmirësimet e fundit në administrimin e doganave. Një prioritet i mëtejshëm është të përmirësohet kuadri financiar dhe ligjor për investitorët, si pjesë e procesit për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për aktivitetin e sektorit privat”. (FMN, Konferencë shtypi No. 01/59, 13 qershor 2001.)*

Kjo ndërthurje bazash të forta dhe me një kohë relativisht të gjatë para pranimit në Bashkimin Europian dhe akoma më shumë për anëtarësimin në Bashkimin Monetar Europian, ngre shumë pyetje. Së pari, a duhet Shqipëria tani të vendosë një lidhje më të ngushtë me euron për shembull, një kurs këmbimi të caktuar apo një shkallë të paqëndrueshme të regjimit aktual të shkëmbimit? Së dyti, a duhet Shqipëria të ndërmarrë veprime të njëanshme kundrejt një kursi këmbimi të caktuar me euron? Ky lloj “euroizimi” do të merrte një ose dy forma; (1) zëvendësim zyrtar dhe total të lekut me euron ose (2) një bord monedhë që do të lidhte lekun me euron në një barazi të pathyeshme e të fiksuar. Cila do të ishte kostoja e përfitimeve për Shqipërinë nga një veprim i tillë? Si do të

ndikonte përshtatja graduale me standardet e Bashkimit Europian me këto kosto dhe përfitime? Cilat do të ishin pasojat për zhvillimin e negociatave me Bashkimin Europian? Këto janë çështjet e prekura në këtë diskutim.

#### **LEKU, EURO DHE DOLLARI**

Regjimi luhatës i kursit të këmbimit të lekut të luhatjes së kontrolluar paraqet disa karakteristika interesante:

(i) Si monedhat e të gjitha ekonomive në tranzicion, pa asnjë përjashtim, leku ka patur tendencën drejt një rivlerësimi real. Ky është fenomeni i ekuilibrit, dhe kjo nuk është vetëm pasojë e ndikimit të efektit Belassa-Samuelson (rendimenti në prodhimin e mallrave të tregtueshëm është më i madh se sa ai i atyre të patregtueshëm dhe rrit rrogat dhe çmimet në sektorin e mallrave të patregtueshëm) por, gjithashtu, dhe veçanërisht si pasojë e nënçmimit natyral të monedhave në fillimet e tranzicionit, për shkak të pasigurive dhe të rreziqeve politike, dhe të mundësisë së inflacionit.

(ii) Ndryshe nga monedhat e tjera në zonë, duke përjashtuar shkëputjet e shkurtra e të përkohshme, leku është mbiçmuar në terma nominalë për shkak të inflacionit të ulët, në vend që të ishte mbiçmuar vetëm në terma realë nëpërmjet një ndryshimi pozitiv të inflacionit më të lartë se nënvlerësimi nominal.

Në këtë mënyrë, kursi efektiv i këmbimit, duke marrë 1995=100, ra ndjeshëm në gjysmën e parë të vitit-krizë 1997 nga 110 në 75, pastaj u përmirësua në gjysmën e dytë të vitit 1997 dhe pati rritje në vlerë si në nominale, dhe akoma më shpejt në atë reale, nga 130 në 140, përkatësisht në mes të vitit 2001 (shiko figurën 1). Kjo është për t'u vlerësuar, sidomos kur marrim parasysh kufizimin e shpejtë të ndryshimeve të normës së interesit, përse i përket si Zonës së Euros ashtu edhe të dollarit, e cila mund të ketë dobësuar lekun.

(iii) Rivlerësimi real nuk duket se e ka dëmtuar dhe aq konkurrencën në Shqipëri; një deficit tregtar relativisht i madh është shndërruar në një deficit të arsyeshëm të llogarisë korente në nivelin 7 për qind të PBB-së, e mbuluar kjo lehtësisht nga paratë e dërguara nga emigracioni (besohet që në realitet të jetë rreth dyfishi i vlerës zyrtare të 500 milionë dollarëve) nga hyrjet e të ardhurave të privatizimit dhe nga shërbimet turistike. Në fakt, Banka e Shqipërisë ka akumuluar rezerva valutore në një nivel të përshtatshëm, duke arritur, në fund të marsit 2001, një shumë prej

648 milionë dollarësh, që i përkasin 4.4 muaj importi. (FMN 2001 a.)

(iv) Leku pati një rritje vlere më të shpejtë në lidhje me euron se sa me dollarin amerikan; vitet e fundit duket të ketë ndjekur më nga afër dollarin (shiko fig. 2). Kjo është e papritur përse i përket tregtisë së Shqipërisë me Bashkimin Europian, e cila është 100 herë më e madhe se sa me SHBA. Në tregtinë e vitit 2000, pjesa me Bashkimin Europian, korrespondoi në mbi 90 për qind të eksportit të Shqipërisë (nga kjo 70.3 për qind me Italinë, 12.9 për qind me Greqinë, 6.6 për qind me Gjermaninë) dhe 75 për qind e importit (nga kjo 36.2 për qind nga Italia, 28 për qind nga Greqia, 5.5 për qind nga Gjermania). Anasjelltas, tregtia me SHBA përbën vetëm 0.8 për qind të eksportit të Shqipërisë dhe 0.7 për qind të importit; edhe nëse gjithë tregtia jashtë Bashkimit Europian (përfshirë atë me ish- CMEA, që arrin në 2.1 për qind të eksporteve dhe 11.4 për qind të importeve) do të trajtohej si tregti me dollarë, prapëseprapë do të ishte nën 10 për qind të eksporteve dhe një të katërtën e importeve.

Gligorov (2001) shkruan se për vendet e Ballkanit, përfshirë këtu dhe Shqipëria, “euro është e ardhmja monetare e të gjithë rajonit.” Por, për Shqipërinë mund të themi se, *bazuar në konsideratat në drejtim të tregtisë*, euro është e tashmja e saj monetare. E megjithatë, dollari ka një rol mbizotërues në Shqipëri, si njësi llogarish, depozitash dhe si mjet pagese. Në vitin 2000, u krye një studim i hollësishëm i tregut shqiptar të këmbimit (duke përfshirë të 13 bankat tregtare dhe 21 zyrtat e këmbimit, 50 kambistë të palicencuar të rrugës, 150 ndërmarrjet më të mëdha dhe 100 individë; shih: Baleta dhe Çeliku, 2000.) Nga ky studim, doli se 67.8 për qind e të intervistuarve parapëlqenin përdorimin e dollarit në transaksionet e tyre, 86.2 për qind e konsideronin dollarin si “valutën më të rëndësishme që i udhëzon në vendimmarrje”. Kurse euro nuk i përmirësoi pozitat e saj në vitin 2000 në krahasim me ato të vitit 1999.

Për më tepër, depozitat në valutë të huaj kanë qenë të larta dhe madje në rritje (shih figurën 3), duke përfaqësuar 27.8 për qind të të gjitha depozitave në vitin 2000, të parashikuara në 28.9 për qind në vitin 2001 (FMN, 2001b). Sipas zyrtarëve të bankës, të paktën gjysma e depozitave të huaja llogaritet të jenë në dollarë. Shifrat e sakta janë të vështira për t'u nxjerrë, por një sasi relativisht e madhe dollarësh në qarkullim vjen si rezultat i mospërputhjes së vlerësimeve zyrtare dhe atyre jozyrtare përse i përket dërgesave nga emigrantët (shumica në dollarë), i besimit të shfaqur nga të

gjithë për një ekonomi jozyrtare në shkallë të gjerë, dhe i përvojës së vendeve të tjera të Ballkanit. Nuk mund të jetë një rastësi që në tregun valutor shqiptar, në dhjetor të vitit 2001, dollari kryesonte para markës gjermane dhe valutave të tjera europiane, në krahasim me raportet e tyre në tregjet e tjera botërore.

Ky rol dominues i dollarit hedh disa dyshime –si do ta shohim dhe më poshtë - mbi atë nëse Shqipëria duhet apo jo të lidhet më ngushtë me euron.

#### **KURSI I LUHATSHËM KUNDREJT KURSIT TË PANDRYSHUESHËM TË KËMBIMIT**

Në fillim të vitit 1990 i ashtuquajtura konsensus i Uashingtonit mbi ekonominë në tranzicion, nuk përfshinte një kurs këmbimi të rekomanduar. Një kurs i luhatshëm besohej të ishte i mirë për vendet me çmime nominale dhe paga të pandryshueshme, të përmasave të mëdha dhe me një tregti të jashtme me hapje të vogël, një koincidencë të lartë *shock* asimetrike, gamë të ngushtë prodhimesh, faktorë të ulët lëvizshmërie nëpërmjet kufijve veçanërisht për punë; e kundërta vlen për kurset e pandryshueshme të këmbimit.

Në parim, besohej se kursi i luhatshëm do të ruante konkurrencën dhe, rrjedhimisht, vendet e punës, duke shkaktuar inflacion të lartë, kurse një kurs këmbimi i caktuar, në të kundërt, do të frenonte inflacionin në kurriz të konkurrencës dhe rrjedhimisht të vendeve të punës. Zgjedhja mes inflacionit dhe papunësisë mbetej në dorën e qeverive në fuqi. Për më tepër, çdo kurs këmbimi i drejtuar me sukses ka një prirje drejt justifikimit të vetvetes përmes një ndikimi në inflacionin e brendshëm; dhe efektshmëria e çdo regjimi të një kursi këmbimi varet plotësisht nga politika monetare që e shoqëron. Në këtë mënyrë, në ekonominë në tranzicion mund të gjendet e gjithë gama e regjimeve të kurseve të këmbimit, nga ato super të luhatshmet deri tek ato super të pandryshueshmet, mes të cilave hasen të gjitha regjimet e mesme. Në fund të viteve '90, u shfaq një zbatim i ri i bindjeve të pranuar, që u quajt "pikëpamja bipolare", e cila ishte në favor ose të kurseve super të pandryshueshme, domethënë të këmbimeve zyrtare të valutave apo një tabele valutash, ose të kurseve krejtësisht të luhatshme (Shih: Fisher 2001). Regjimet e mesme të kurseve të këmbimit edhe nëse ruhen me sukses – madje *sidomos* nëse ruhen me sukses – e bëjnë ekonominë të cënueshme nga vërshimet brenda dhe jashtë të kapitalit, të cilat në fillim e forcojnë valutën deri në nivele që nuk mund të ruhen dhe të pakonkurrueshme; pastaj e

dobësojnë atë përtej çdo arsyeje, me tërheqje të papritura parash duke shkaktuar panik dhe kolaps. Kështu që, në gjysmën e dytë të viteve '90 pati një devijim të dukshëm nga regjimet e mesme të kurseve të këmbimit drejt atyre ekstreme, si atyre super të luhatshme ashtu dhe atyre super të pandryshueshme. (Shih: Fisher 2001, i cili sidoqoftë e konsideron një kurs të mesëm, me synim kontrollimin e inflacionit, si një kompromis të arsyeshëm.)

Jashtë këtyre dy ekstremeve, një kurs këmbimi i luhatshëm shpesh shihet i lidhur me vijë të pjerrët inflacioni, paqëndrueshmëri dhe turbullira të përsëritshme. (Mundell 2000.)<sup>21</sup> Nëse e pranojmë këtë argument, regjimet super të pandryshueshme duken zgjidhja më e pranueshme në një vend që shfaq integrim të thellë tregtar me zonën, valutën e të cilës përdor.

### **KURSI HYPER FIKS I KËMBIMIT**

Ka një ngjashmëri të jashtëzakonshme, megjithëse është kuptuar pak, midis anëtarësimit në një Bashkim Monetar, zëvendësimit zyrtar të monedhës dhe një regjimi me Bord Monedhë. Anëtarësimi në një Bashkim Monetar përfshin zëvendësimin total dhe zyrtar të valutës nga valuta e Bashkimit, me një kurs këmbimi të rënë dakort më parë dhe zakonisht objekt i kushteve konvergjente – për anëtarësimin në Bashkimin Monetar European, në Bashkimin European dhe për kushtet e përmendura më sipër të Maastricht-it ka të drejta dhe detyra të tjera si për shembull, përfaqësimi në Këshillin Qeverisës të Bankës Qendrore Europiane<sup>22</sup>; të pasurit e të drejtës së pronësisë në bashkëpunim drejtpërdrejt apo në mënyrë indirekte; transferimi i pjesës më të madhe të rezervave të brendshme në Bankën Qendrore Europiane, përfshirja në koordinimin dhe në mbikëqyrjen e politikave ekonomike, respektimi i të ashtuquajturit pakt për “zhvillim dhe stabilitet”.

Efektet e anëtarësimit të *rënë dakort më parë* në një bashkim monetar njëvalutor –për shembull, dollari apo euro – mund të për afrohen me dollarizimin apo euroizimin e *njëanshëm*, e kuptuar kjo si një zotim për një regjim kursi këmbimi të ashtuquajtur

<sup>21</sup> Kurset totalisht të pandryshueshme, ndryshe nga kurset fikse që dhe mund të ndryshohen herë pas here, nuk nxisin spekulimet – siç provohet nga përvoja e anëtarëve të Bashkimit Monetar European, që nga maji i vitit 1998, në kundërshtim me krizën në ERM të shtatorit të vitit 1992 dhe braktisjes së tij nga Mbretëria e Bashkuar dhe Italia. (Një mosmarrëveshje e harruar nga Larrain dhe Sachs, 1999, në numërimin e argumenteve të tyre kundër dollarizimit.)

<sup>22</sup> Me zgjerimin e BE-së, ndoshta do të nevojiten rregulla të reja për të kufizuar numrin e pjesëmarrësve në Këshillin Qeverisës të BQE-së nëpërmjet një sistemi rotacioni apo në varësi të rajoneve, në mënyrë që të mos jetë tepër i ngadaltë.

“hyperfiks“ (super të pandryshueshëm), i cili mund të marrë dy forma:

*(1)zëvendësimi i plotë dhe zyrtar i monedhës, i ndërmarrë në mënyrë të njëanshme, përpara ose pa anëtarësim në një Bashkim Monetar. Sigurisht, sa më e dollarizuar jozyrtarisht të jetë një ekonomi, aq më shumë do t'i afrohet ajo një ekonomie zyrtarisht të dollarizuar pa e arritur kurrë, pasi ato çmime që zakonisht shprehen në monedhën vendase – veçanërisht pagat – nuk indeksohen kurrë plotësisht e në mënyrë të menjëhershme (për të mos thënë aspak) me kursin e këmbimit të dollarit;*

*(2)një bord valutor emeton monedhën vendase vetëm në këmbim të valutave të konvertueshme me një kurs të fiksuar përkundrejt valutës referuese. Kur kjo marrëveshje të paraqitet, monedha që ekzistonte më parë mund të mbahet ose të zëvendësohet, për sa kohë që mbulohet nga rezervat e huaja me të njëjtin kurs. Në interes të përshtatshmërisë dhe të impaktit psikologjik, monedha vendase – ose sido që mund të quhet – gjithashtu, mund të ridominohet në mënyrë që të bëjë njësinë e saj ekuivalente me një njësi të monedhës referuese, si për shembull euro (si barazia e pezoz së Argjentinës përballë dollarit amerikan, që u vendos në vitin 1991 dhe që përfundoi në janar të vitit 2002).*

Në këtë diskutim termat dollarizim/euroizim po përdoren për të emërtuar të dyja si zëvendësimin e monedhës, ashtu edhe regjimin e bordit monetar, përveçse kur kemi të bëjmë me ndryshimet e tyre kur këto të dyja do të përmenden në mënyrë të veçantë. Ngjashmëria midis dy regjimeve, dhe afërsia e tyre me Bashkimin Monetar, kuptohen më mirë kur ndërrohen me njera-tjetrën.

Një bord monetar mund të ndryshojë në zëvendësim monetar në çdo kohë, duke humbur kështu sovranitetin e simboleve dhe të interesit mbi rezervat e përdorura për të hequr monedhën kombëtare nga qarkullimi, dhe përfitimet për të ulur më tej çdo rrezik të mbetur në kursin e tij të këmbimit dhe, duke mos administruar monedhën. Kostot dhe përfitimet do të pasqyroheshin në një lëvizje të supozuar, ndoshta dhe të kundërt nga përdorimi i përgjithësuar i monedhës së huaj në një bord monedhë që lidhet me të. Anëtarësimi në Bashkimin Monetar është i barabartë me zëvendësimin zyrtar dhe total të monedhës plus të drejtat dhe detyrimet e anëtarësimit, të përmendura më lart. Këto ndryshime dhe ngjashmëri kuptohen pak, si nga Banka Qendrore Europiane ashtu edhe nga Komisioni European, kur këto pranojnë miratimin e një bord monedhë nga vendet candidate (për shembull, Bullgaria), por refuzojnë zëvendësimin e monedhës sikur kjo të përfshinte të

njëjtat të drejta si anëtarësimi në Bashkimin Monetar European (shiko poshtë, pika 8).

#### **DOLLARIZIM/EUROIZIM I PJESSHËM JOZYRTAR**

Zëvendësimi total dhe zyrtar i monedhës nuk duhet të ngatërrohet me zëvendësimin e pjesshëm dhe jozyrtar të monedhës. Për një kohë të gjatë marka gjermane (si pasojë dhe euro, nga 1 janar 1999 për veprime jomonetare dhe, gjithashtu, edhe për monedhën nga 1 janar 2002) është përdorur gjerësisht në Europën Lindore Qendrore dhe në Ish-Bashkimin Sovjetik (IBS), pranë, dhe nganjëherë preferohej më shumë se dollari amerikan, si njësi llogarie, rezervë valutore dhe mjet pagese bashkë me monedhën e vendit përkatës. Ky lloj “dollarizimi” jozyrtar dhe i pjesshëm është i zakonshëm edhe në vende të tjera sidomos në Amerikën Latine, ku ka qenë objekt për kërkime të mëtejshme (shiko Calco 1999, Fondi Monetar Ndërkombëtar 1999, Senati SHBA JEC 1999, Berg dhe Borensztein 2000).

Federal Rezerva vlerësoi që në vitin 1998, 40 – 60 për qind e dollarëve amerikanë, monedha e kartëmonedha, që ishin në qarkullim, të cilët i korrespondojnë shumës 192-288 miliardë usd, qarkullojnë jashtë vendit. (Feige et al., 2000.) Marka gjermane përdorej gjerësisht jashtë Gjermanisë, veçanërisht në Europën Qendrore e Lindore. Në vitin 1995, Banka Kombëtare Gjermane llogariste se rreth 30-40 për qind e të gjitha kartëmonedhave e monedhave marka gjermane ishin në qarkullim jashtë vendit. (Seitz 1995.) Që atëherë, të paktën në një grup prej pesë ekonomish në tranzicion të mbajtura nën vëzhgim (Kroacia, Hungaria, Sllovenia, Republika Çeke dhe Sllovakia) duket të ketë pasur (i) një rënie në investime si në marka gjermane ashtu dhe në dollarë amerikanë, dhe (ii) një kalim nga marka gjermane në dollarin amerikan (Stix 2001), ndoshta në vazhden e përpjekjeve për t’iu shmangur pasojave fiskale dhe atyre penale të kapitaleve në valutë të huaj, që do të lundronin në ajër gjatë këmbimit nga marka gjermane në euro, pas janarit të vitit 2002.

Ndonjëherë, ky shkëmbim valute jozyrtar duket si e anasjellta e ligjit të Gresham-it, paratë e mira përzënë paratë e këqija në vend që të ndodhte e kundërta, por nuk është ashtu. Ligji i Gresham-it zbatohet në kurset e pandryshueshme të disekuilibruara ndërmjet kursit ligjor, me debitorët që natyrisht preferojnë të paguajnë në valutën më të dobët (domethënë zakonisht të mbivlerësuar zyrtarisht). Me dollarizimin jozyrtar, të dyja monedhat janë të mira, secila prej tyre më e mirë se tjetra vetëm në kryerjen e disa

funksioneve specifike; përparësitë e tyre relative përcaktojnë një kurs këmbimi fleksibël ndërmjet të dyjave, jo të caktuar me ligj, por të vendosur nga agjentë ekonomikë. Në sistemet sovjetike, në të kaluarën, monedha e huaj përdorej, edhe pse ishte e jashtëligjshme, për shkak të lëkundjeve të monedhës vendase nga inflacioni i mbajtur artificialisht i ulur, dhe për shkak të fleksibilitetit dhe të sigurisë së saj më të madhe. Pas tranzicionit, më shumë përdorej për shkak të probabiliteteve inflacioniste të vazhdueshme, shumë më të larta sesa në çmimet në monedhë të huaj.

Duke patur parasysh rivlerësimin nominal real dhe të barazpeshuar të lekut, inflacionin shumë të ulët dhe interesat në ulje, shkalla e lartë dhe akoma në ngritje e dollarizimit dhe markaizimit/euroizimit në Shqipëri është një fenomen i habitshëm. Për më tepër, duke patur parasysh konsideratat e mësipërme në drejtimin e tregut, është po aq e habitshme gjetja e përdorimit më të gjerë të dollarit sesa të monedhave të vendeve në Zonën e Euros, pavarësisht se tregtia me Bashkimin Europian është njëqind herë më e madhe sesa tregtia me SHBA-në (shih: seksioni 2, më sipër).

Shpjegimi më i pranueshëm për këto çudira monetare duhet të jetë dollarizimi gjithëpërfshirës si i aseteve ashtu dhe i borxheve, në sektorin publik dhe në atë privat, dhe mbizotërimi i dollarit në faturimet e tregtisë së jashtme, pavarësisht nga zona valutore e partnerëve me të cilët bëhet tregti. Euro mund të ketë dështuar në përpjekjet për të zëvendësuar dollarin për shkak të dobësive të saj pas hedhjes në treg në janar të vitit 1999, e cila erdhi pas një kombinimi të rritjes së ulët ekonomike të Bashkimit Europian, mangësisë së një uniteti politik dhe përfaqësie në Zonën e Euros, si dhe administrimit që linte për të dëshiruar. Deri në janar të vitit 2001, mungesa e kartëmonedhave dhe e monedhave u duk qartë se e kufizoi përdorimin e euros si mjet pagese dhe në këtë mënyrë kufizoi, gjithashtu, joshjen e saj si një monedhë alternativë; ndërkaq, hyrja e monedhave dhe e kartëmonedhave euro ngriti kostot e transaksioneve për mbajtësit e valutës euro në momentin e këmbimit.

Dollarizimi dhe euroizimi jozyrtar, si në Shqipëri, është si një përparësi ashtu dhe një pengesë kur merret parasysh përshtatja zyrtare e një regjimi super të pandryshueshëm: kalimi ndihmohet nga sasia relativisht e madhe e valutave të huaja në qarkullim, por për shkak të qarkullimit si të dollarit amerikan ashtu dhe të euros duhet bërë *një largim i ekonomisë nga monedha që nuk do të përdoret më*. Në këtë gjendje që janë gjërat tani, një kalim i mundshëm i Shqipërisë në një kurs super të pandryshueshëm mund të merrte vetëm formën e një bord monedhë të lidhur me

shportën e euros dhe të dollarit, gjë që do të sillte përfitimet e një regjimi super të pandryshueshëm, por jo ato të një zone me një monedhë.

#### **PËRFITIMET NGA EUROIZIMI**

Për një trajtim më gjithëpërfshirës të nënkuptimeve ekonomike të euroizimit i referohemi Nuti (2001); këtu do të merremi me kostot dhe përfitimet që kanë lidhje me Shqipërinë. *Në përgjithësi, shohim se si kostot ashtu dhe përfitimet ka mundësi të jenë ekzagjeruar, që ka mundësi të ketë efekte neto pozitive, e që këto përfitime neto të bëhen më të mëdha me progresin drejt përshtatjes ndaj standardeve të Bashkimit Europian.*

Nga ana e përfitimeve do të gjejmë sa vijon:

(i) *Siguri më të madhe të kursit të këmbimit.* Në teori, si zëvendësimi i valutës ashtu dhe bord monedha, përbëjnë një përkushtim të përhershëm, të pakthyeshëm për një kurs këmbimi të pandryshueshëm. Si thonë Larrain dhe Velasco (2001), “Nuk mund të zhvlerësohet me lehtësi një valutë që nuk ekziston apo një valutë, kursi i këmbimit të së cilës është i vendosur me ligj.” Megjithatë, ata flasin si avokatët e djallit, pasi, përkundrazi, një valutë që nuk ekziston mund të kthehet kurdoherë në ekzistencë, dhe, kur kursi i këmbimit është i vendosur me ligj, ai mund të ndryshohet, gjithashtu, me ligj. Me të vërtetë, Bratkowski dhe Rostowski (2000) në të njëjtën frymë rekomanduan zëvendësimin e zllotit me euro dhe parashikuan një kthim të mundshëm. Mbetet për t’u provuar se kthime të tilla të politikave mund të jenë aq të kushtueshme sa të ndalojnë një qeveri së marri më vendime të tilla; mund të arrijnë në një pikë sa qeveria mund të mos ketë më rrugëzgjdhje tjetër (si Argjentina në dhjetor 2001), dhe kostoja më e madhe e rikthimit (përkundrejt regjimeve të tjera të kurseve të këmbimit) mund ta përkeqësojë krizën në vend që ta parandalojë atë. Të themi të drejtën nuk ekziston një regjim super i pandryshueshëm kursi këmbimi. Është e vërtetë që edhe vendet që kanë një monedhë të përbashkët mund të ndahen përsëri (si në rastin e Bashkimit Sovjetik, të Jugosllavisë etj.). Ndërsa në rastin e zëvendësimit të monedhës dhe sidomos të një bord monedhe, mbetet gjithmonë një rrezik i paneglizhueshëm zhvlerësimi, i parë qartë në ngritjen e normës së interesit për debitorë të shkallës së njëjtë. Është e rëndësishme që në Bosnje, në vitin 2001, marka vazhdoi të qarkullojë si një monedhë paralele, përkrah një valute të lidhur me markën gjermane (megjithëse në një shtrirje me zvoglim të shpejtë) duke treguar se edhe adoptimi i një bord monedhe

mund të jetë i pafrytshëm nëse nuk paraprihet nga reforma gjithëpërfshirëse ekonomike e politike. *Ky përfitim për Shqipërinë, duke patur parasysh rritjen në stabilitet dhe organizimin, është shumë i vogël.*

(ii) *Kredibilitet më i madh i politikës qeveritare.* Shpesh thuhet, edhe për një politikë kursi këmbimi të pandryshueshëm dhe, aq më tepër, për një regjim super të pandryshueshëm, se një qeveri të cilës i mungon kredibiliteti i politikave dhe një regjistër, mund “të marrë hua” kredibilitet duke e ankoruar monedhën kombëtare përkrah një monedhe të fortë e të besueshme. Megjithatë, nuk është e sigurtë nëse kredibiliteti mund “të huazohet”, pasi forca e një zinxhiri nuk mund të jetë më e madhe sesa forca e hallkës së tij më të dobët, e cila këtu është kredibiliteti i përkushtimit të qeverisë kombëtare ndaj një politike të tillë apo të një politike të *çfarëdoshme*. Ta zëmë se Rusia do të kishte nisur një bord monedhë në fund të gushtit të vitit 1998, pas mospagimit në kohë të mbi 40 miliardë dollarëve amerikanë si borxh qeveritar, dhe të një borxhi akoma më të madh publik të denominuar në rubla; duket diçka naive të besosh se një përkushtim ndaj një barazie të përhershme të pandryshueshme me monedhat e forta në atë kohë, do të ishte gjykuar si i besueshëm nga tregjet financiare ndërkombëtare. *Në Shqipëri, me një bankë qendrore të pavarur e të mirëadministruar, kjo fitore do të kishte qenë e papërfillshme.*

(iii) *Kosto më të ulta transaksionesh.* Pa dyshim, përdorimi i një valute të përbashkët si masë vlerësimi, por edhe si mjet këmbimi çon në kosto më të ulta transaksionesh, megjithëse këto kursime ka mundësi të jenë të zmadhuara. Është e vërtetë se çdokush që do të këmbente me rradhë secilën prej 12 valutave të Zonës së Euros, e pastaj të kthehej përsëri tek valuta fillestare do të humbiste shumicën e kapitalit fillestar, për shkak të komisioneve të paguara; edhe me një komision modest prej 2 për qind për çdo transaksion do të humbej pothuajse një e katërta e shumës fillestare. Megjithatë, askush me mend në kokë nuk do të ishte aq i papërgjegjshëm sa të mos ia përshtasë sasinë e valutës së huaj që zotëron, shpenzimeve të tij të mundshme. Si rezultat, fitimi total në këto rrethana nuk ka mundësi të jetë shumë më i lartë sesa 2 për qind, edhe nëse shpenzimet totale nuk përputhen 100 për qind me të ardhurat totale. Një mospërputhje e tillë është krejtësisht e pambështetshme, kështu që fitimet në koston e transaksioneve kanë më shumë mundësi të jenë, të themi, rreth 1 për qind apo më pak të vlerës së transaksioneve.

Përdorimi i një njësie të vetme llogarie i bën çmimet më transparente, por ne nuk duket se kemi shumë vështirësi në të krahasuarit me çmimet relative (të brendshme/të huaja) kur udhëtojmë në vende të huaja, që përdorin valutë të ndryshme apo kur krahasojmë listat e çmimeve në valuta të ndryshme. Prandaj, *në përgjithësi, fitimet në kostot e transaksioneve janë të pranishme, por ndoshta janë pak të ekzagjeruara, dhe Shqipëria nuk përbën përjashtim në këtë rast.*

*(iv) Normat më të ulta të interesave.* Ka mundësi të ketë norma më të ulta interesi në valutën e re, gjë që do të nxisë investimet dhe rritjen ekonomike. Gjithësesi, primi i rrezikut i vendit, sidomos në një bord monedhë, nuk mund të eliminohet krejtësisht në praktikë, dhe mund të mbetet i konsiderueshëm. Në Argjentinë, për shembull, pas dhjetë vjetësh që bord monedha vazhdonte ta lidhte me sukses në barazi peson me dollarin, në nëntor-dhjetor 2001, në vigjilje të kolapsit, mbizotëroi një prim normash interesi prej 25 për qind deri në 40 për qind mbi kursin e dollarit. Ka shumë mundësi që primet e interesave do të jenë më të ulëta sesa me regjimet alternative të kurseve të këmbimit, por jo domosdoshmërisht zero, madje as në rastet e zëvendësimit total të valutës. Përveç kësaj, mbi rrezikun e një vendi (i njëjtë me rrezikun e huadhënies) mbetet një prim që mbulon huadhënësin nga rreziku i mospagimit.

Pa dyshim, si qeveria ashtu edhe investitorët privatë përfitojnë nga një monedhë e përbashkët nëpërmjet aftësisë së tyre për të huazuar nga vende të tjera në monedhën e tyre, e njëjta në të cilën shpenzimet janë të denominuara (Hausmann 1999, Hausmann *et al.* 2000). Përsëri, një përfitim i tillë është ndoshta i ekzagjeruar në diskutimet ekonomike. Për më tepër në Shqipëri, norma e interesit ka rënie të dukshme, me një shkallë rënieje të interesit të bonove të thesarit tremujore nga 35.9 për qind në vitin 1997, në 7.8 për qind në vitin 2000; *përfitimet në normat e interesave, nëse ka ndonjë, në Shqipëri do të ishin shumë të vogla.*

*(v) Stabilitet më të madh makroekonomik.* Një aspekt bindës si në zëvendësimin e monedhës dhe në bord monedhë është prania e rregullatorëve automatikë në ofertën për para, e vendosur nga ndryshimet në asetet e huaja të ruajtura brenda vendit, të ngjashme me ndryshimet që ndodhin nën një standard ari. Shpejtësia dhe intensiteti i këtyre vetërregullatorëve ka pak mundësi – ashtu si edhe nën standardin e artë – që të mjaftojnë për të siguruar një stabilitet të plotë, por janë gjithashtu të pamjaftueshme për të bërë ndonjë dëm. Përsëri, ka një përfitim të vogël, por ndoshta të ekzagjeruar që vjen nga bord monedha apo

nga zëvendësimi i valutave.<sup>23</sup> Përfitime më të rëndësishme në stabilitet mund të vijnë nga argumenti "bipolar" i diskutuar më lart. Bratkowski dhe Rostowski (2000) e shikojnë eliminimin e rrezikut të krizës monetare si një përfitim të madh për euroizimin. Por, një monedhë e përbashkët nuk e eliminon pa shpenzime rrezikun e deficiteve të llogarisë korente, që vijnë nga monedha e brendshme, ajo thjesht i transformon ato në rreziqe të rajoneve nën zhvillim. Rreziqe të tilla mund të jenë më të vështira dhe mund të zgjasin më shumë, se sa një krizë monetare e përkohshme (sidomos pa dispozitat për transfertë nga buxheti i Bashkimit Europian, i cili do ishte vetëm në përfitim të anëtarëve të Bashkimit Europian). *Për Shqipërinë, dhe në përgjithësi në këto raste, përfitimet në këtë rast do të ishin të vogla.*

(vi) *Tregti më e madhe dhe investime të huaja direkte më të mëdha.* Deri kohët e fundit, puna studimore ka dështuar në gjetjen e një lidhjeje empirike të besueshme midis rregullimeve monetare dhe flukseve tregtare. Andrew Rose (2000), në të kundërt, pretendonte se bashkimi monetar ka një efekt dramatik në tregti. Ai vuri në dukje se vendet që përdorin monedhë të përbashkët tregtojnë me njëri-tjetrin gati 300 për qind më shumë se vendet e ngjashme, të cilët përdorin monedha të ndryshme. Në lidhje me këtë fakt, ai nuk mund të tregonte burimin e këtij efekti të jashtëzakonshëm, prandaj i paralajmëroi lexuesit të mos nxjerrin konkluzione të gabuara nga rezultatet e tij në lidhje me Bashkimin Monetar Europian dhe bashkime të tjera monetare. Torsten Persson (2001), e vlerësoi më shumë këtë dhe la mënjanë konkluzionin e Rose-së. Sipas tij, vendet që përvetësojnë një monedhë të përbashkët janë grupe të vetpërzgjedhura, domethënë janë gjithashtu ato vende për të cilat një monedhë e përbashkët ka efektin më të madh në tregti, dhe ai mori parasysh përcaktues të tjerë të mundshëm të intensitetit të tregtisë.

Si rezultat, ndikimi i një monedhe të përbashkët duket shumë i vogël, rreth 40 për qind, dhe shumë më pak i saktë.<sup>24</sup>

---

<sup>23</sup> Në një ekonomi që është tashmë gjerësisht e euroizuar, lëvizja drejt zëvendësimit total dhe zyrtar të monedhës, do të eliminonte komplikacionet e komponentëve të dyanshëm në ofertën monetare, duke vendosur qëllime të ndërmjetme të politikës monetare.

<sup>24</sup> Përgjigjia e Rose, rikthen pretendimet për një vlerësim më të madh e më preciz të ndikimit të një monedhe të përbashkët mbi tregtinë, por diskutuesi Patrick Honohan dhe paneli "Politika Ekonomike", në të cilin u botuan këto kumtesa, dolën në përfundimin se "efektet e dukshme mbi tregtinë e bashkimeve monetare – si të mëdha ashtu edhe të vogla" mund të jenë në të vërtetë pasojë e adoptimit, në të njëjtën kohë, të politikave të tjera nga vendet e interesuara. (Hyrja e Botuesve, *Politika Ekonomike*, Tetor 2001, f.260.)

Ky rikonsiderim drastik i zgjerimit të tregtisë kuptohet më mirë duke bërë një analogji me kërkimet mjekësore, ku efektiviteti i një mjekimi të veçantë për pacientët nën këtë mjekim nuk mund të përgjithësohet për të gjithë pacientët që nuk janë nën këtë kurë.

Po kështu, efekti i vlerësuar për bashkimet monetare ose për zonat monetare, çfarëdolloj përmase qofshin, nuk mund të jetë i ekstrapoluar në një grup të vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore, ku i vetmi tipar i përbashkët është thejsh një ish-regjim ekonomik komunist, dhe ku tipari kryesor që ka të përbashkët me Zonën e Euros, është dëshira të bashkohet me të së shpejti. Për më tepër, vendet e Eurozonës po përballen me dobësitë e tyre në tregtinë e jashtme, në vend që të forcohen, e nuk mendojnë për t'u zgjeruar më shumë.

Një ndikim pozitiv mbi tregtinë mund të ketë, jo drejtpërsëdrejti, një efekt jo të favorshëm në investimet e huaja direkte, të cilat të paktën deri në njëfarë shkalle janë një lloj zëvendësimi për tregtinë direkte (shiko Bevan dhe Estrin 2001); që një monedhë e përbashkët të ketë një ndikim të përgjithshëm neto pozitiv mbi IHD-të, duhet të jetë më shumë se e kompensuar nga efektet pozitive, që një monedhë e përbashkët mund të ketë mbi klimën e përgjithshme të biznesit dhe perspektivat e rieksporimit. Në të njëjtën kohë, norma më e ulët e interesit, e pritur nga hyrja në treg e një monedhe të përbashkët duhet të rrisë vërshimin e kapitalit financiar.

*Në të njëjtin këndvështrim, përfitimi i konsiderueshëm megjithëse jospespektakolar, në masën prej 40 për qind të tregtisë së jashtme është, gjithashtu, një përfitim domethënës për Shqipërinë.*

#### **KOSTOT E EUROIZIMIT**

Euroizimi i njëanshëm do të kishte dhe kostot e tij:

(i) Para së gjithash, humbja e “*seigniorage*” – të ardhurat e fituara nga përdorimi i monedhës së brendshme, zakonisht përcaktohet si vlera e vërtetë e ndryshimit në paratë bazë.<sup>25</sup> Në rastin e bord monedhës disa nga të ardhurat “*seigniorage*” që do t'i shtoheshin bankës qendrore sigurohen nga interesat e fituar nga rezervat.

<sup>25</sup> Ka gjithashtu përkufizime të tjera, si për shembull norma nominale e interesit mbi paratë në qarkullim, ose të ardhurat neto nga veprimet e bankës qendrore në lidhje me krijimin dhe administrimin e parave në qarkullim (të cilat janë një komponent i transferimeve të bankës qendrore në buxhetin e shtetit). Për diskutime dhe vlerësime për Europën Qendrore dhe Lindore shiko: Schobert 2001.

Nën zëvendësimin e valutës humbja e *seignorage*-s mbi masën e valutës së huaj në qarkullim vendas është totale, me përjashtimin se një marrëveshje për ndarjen e saj mund të ishte e arritshme me bankën qendrore që administron valutën në fjalë/të zgjedhur (Calvo 1999, Daviddi 1999); një marrëveshje e tillë u parashikua për vendet e dollarizuara nga Akti Ndërkombëtar i Stabilitetit Monetar i vitit 2000, i paraqitur në Senatin Amerikan nga kryetari i atëherëshëm i Komisionit të Përbashkët Ekonomik, senatori Connie Mack, por që më vonë u harrua nëpër sirtare. Sipas Larry Summers “Në fund të fundit, gjetja e mënyrave për të korrutuar njerëzit për të dollarizuar apo të paktën për të kthyer paratë shtesë që janë fituar kur ka ndodhur dollarizimi, duhet të jetë një përparësi ndërkombëtare...” (cituar nga Komisioni i Përbashkët Ekonomik në Senatin Amerikan, 1999); i njëjti argumentim gjen vend dhe për euroizimin. Humbjet në “*seignorage*”, që rezultojnë nga euroizimi, ndonjëherë nënvlerësohen (për shembull, Bratkowski e Rostowski, 2000, e shpërfillin humbjen e rritjeve të mundshme në “*seignorage*” pas rënies së monedhës vendase) por, gjithashtu, mund edhe të mbivlerësohen (për shembull, nga Larrain e Sachs 1999).

Në ekonomitë në tranzicion *seignorage* është zakonisht e ulët, ndoshta në 1 – 2 për qind të PBB-së (Schobert, 2001), por Shqipëria duket sikur bën përjashtim. Schobert llogariti se në vitet 1994 – '99, në Shqipëri *seignorage* përfaqësonte mesatarisht 4.1 për qind të prodhimit dhe 18.2 për qind të të ardhurave fiskale, më e lartë se sa në vende të tjera me *seignorage* të lartë si Bjellorusia, Ukraina dhe Rumania dhe shumë më e lartë se nën 2 për qind të PBB-së për Poloninë, Hungarinë dhe Republikën Çeke. Pa dyshim, *seignorage* i Shqipërisë në periudhën në fjalë është i lartë, për shkak të një kombinimi të një inflacioni të lartë dhe të ardhurave të pakta fiskale, në një vend që, duke u krahasuar me ekonomi të tjera në tranzicion, është jashtëzakonisht i mirëmonetizuar. Me përmirësimin si në inflacionin e Shqipërisë ashtu edhe në të ardhurat fiskale, *seignorage* është drejt rënies, por do të kishim të bënim akoma me një humbje të konsiderueshme nga euroizimi i njëanshëm. Gjithashtu, një *seignorage* e ulët në ekonomitë në tranzicion shpesh shkaktohet nga humbje të mëdha nga operacionet sterilizuese të bankës qendrore. Humbje të tilla janë pasojë e normave të larta të interesave të brendshëm, të cilat mund të shmangen, dhe si rrjedhim rrisin humbjen e fuqisë, për të mos thënë të *seignorage*-it aktual.

(ii) *Rezervat fillestare*. Rezervat monetare të huaja në shkallë të lartë nevojiten për të vendosur bord monedhë ose për të zëvendësuar zyrtarisht monedhën kombëtare. Në fillim bord monedha duhet të financohet me rezerva të huaja të mjaftueshme për të ndihmuar monedhën në qarkullim (qoftë kjo e re apo e pandryshuar) në kursin e pandryshuar të këmbimit të përzgjedhur nga qeveria. Estonia përfitoi nga kthimi i 11 tonëve ari që ishte dërguar në perëndim para vitit 1940; Lituania, gjithashtu, përfitoi nga kthimi i 6 tonëve ari, gjithashtu, edhe nga blerja nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (OECD 2000). Bratkowski dhe Rostowski (2000) pretendojnë se Polonia (me 26 miliardë dollarë amerikanë, domethënë sa dyfishi i rezervave të nevojshme për të zëvendësuar monedhën e brendshme), Republika Çeke dhe Sllovenia sigurisht mund të përballojnë euroizimin, ndërsa Sllovakia dhe Hungaria quhen si “të mundshme”.

Vende të tjera, që dëshirojnë të euroizohen, mund të kenë më pak fat: Gros (1999) sugjeron që burimet e nevojshme për të futur një bord monedhë (të cilën ai e vlerëson me 269 milionë dollarë për ish-republikat jugosllave, ndoshta një nënvlerësim) mund të huazohen, por kjo do të dobësonte kredibilitetin dhe do të çonte në probabilitetin se kursi i këmbimit nuk do të ishte i përhershëm, por do të zgjaste vetëm sa huaja e marrë dhe rinovimet e mëtejshme. Në fakt, rezervat duhet të jenë të menjëhershme dhe të përhershme në dispozicion ndaj kërkesave të mundshme për kthim paraje, prandaj një bord monedhë nuk mund të krijohet mbi para të huazuara, përndryshe do të bëhej e padallueshme nga një regjim i zakonshëm kursi të pandryshueshëm këmbimi, objekt i rregullimeve të herëpashershme. Kjo, vetëm në rast se nuk financohet të paktën pjesërisht, si Bullgaria, nga institucionet e Bretton Woods-it, dhe në baza afatgjata; në një rast të tillë huaja e huaj kalon në asistencë dhe me të vërtetë mund të marrë formën jo më të një kredie, por të një dhurate. *Shqipëria do të ishte në gjendje, që me rezervat e saj të huaja të mbulonte rreth 70 për qind të parave të saj bazë, duke qenë në këtë mënyrë shumë afër t'ia dalë mbanë me pak ndihmë të huaj dhe kredi afatgjata nga institucionet afatgjata, ashtu si Bullgaria.*

(iii) Humbja e rolit të huadhënësit të fundit. Avantazhi mitik i një bord monedhe është se monedha vendase “i ka krahët e ngrohta” nga valutat e huaja (për shembull, shih Ekonomisti 29-1-2000). Fatkeqësisht, krahët e ngrohta nga valuta e huaj i ka vetëm paraja në qarkullim, domethënë M0, kurse në një krizë valute – siç u provua në mënyrë spektakolare nga Argjentina, në dhjetor të vitit 2001 – nuk ka asgjë që mund ta ndalojë publikun të dojë të

këmbejë në monedhë të huaj më shumë se M0, pra deri në të gjitha pasuritë e tyre të luajtshme, domethënë deri në M2. Në këtë rast, duhet të vihen kufij – *de facto* apo *de jure* – mbi këmbimin në *cash* të parave që ndodhen në bankë, duke rikthyer në këtë mënyrë një segmentim monetar, që ishte tipik i ekonomisë së planifikuar e të centralizuar. Kufij të tillë janë vëzhguar në krizën e Argjentinës, ku u bënë shkaktarë kryesorë të trazirave e të pasigurisë sociale.

Në një ekonomi monetare “normale”, një pakicë parash të thata parandalohet nga banka qendrore, e cila luan rolin e huadhënësit të fundit në parim, duke qëndruar e gatshme të furnizojë me sasi të pakufizuar parash me një normë interesi penal përkundrejt sigurish të forta. Një bord monedhë mund të luajë rolin e një huadhënësi të fundit (HF) vetëm brenda kufijve të rezervave të tepërta mbi M0; nën zëvendësimin total dhe zyrtar të monedhës, banka qendrore mund të vazhdojë të luajë në të njëjtën mënyrë rolin e huadhënësit të fundit brenda kufijve të rezervave të saj në valutë të huaj, të mbetura pas ndërrimit të monedhës. Në Poloni, këto rezerva ishin të konsiderueshme, pothuajse sa gjysma e gjithë parave, por kjo mundësi nuk është e pranishme kudo në atë zonë. Në një krizë likuiditeti këto fitime mund të jenë të pamjaftueshme për të ruajtur një qarkullim të rregullt monetar. Disa sasi parash mund të jepen nga banka të huaja (Calvo, 1999) por vjen një pikë që edhe bankat e huaja parapëlqejnë falimentimin sesa përfshirjen e mëtejshme (si, përsëri, në Argjentinë në 2002-shin); funksioni i huadhënësit të fundit mbetet tepër i cunguar. Në mënyrë që të shmanget mungesa e *cash*-it duhet të rriten normat e interesit që të tërheqin valutën e huaj dhe të nxisin publikun të ulë kërkesën e tij për para, por nuk mund të mendohet se duhet të ekzistojë domosdoshmërisht gjithmonë një nivel i normave të interesit, që ekuilibron kërkesën dhe ofertën për para. Bankat mund të falimentojnë, jo vetëm për paaftësitë e tyre paguese të brendshme (e në këtë rast falimentimi mund të quhej si i nevojshëm, dhe madje një zhvillim i dëshirueshëm në ekonomitë në tranzicion), por edhe thjesht për mungesa *cash*-i, të krijuar artificialisht nga rregullat e bord monedhës mbi çështjet e valutave dhe të rritjes, për pasojë, të normave të interesit.

Në parim, funksioni i huadhënësit të fundit mund të përmbushet pjesërisht nga banka kombëtare e të njëjtës monedhë, madje edhe pa qenë anëtare e bashkimit monetar. Por, për këtë rol nuk ka dispozita statutoare. Në të vërtetë, Akti Ndërkombëtar i Stabilitetit Monetar i cituar më sipër thotë se: “Sistemi Federal i Rezervave nuk është i detyruar të veprojë si huadhënës i fundit ndaj

sistemeve financiare të vendeve të dollarizuara” (paragrafi 2, pika b). Një marrëveshje zyrtare që Banka Qendrore Europiane të vepronte si huadhënës i fundit ndaj vendeve që nuk përputheshin as me kriteret e Maastrichtit, do ta përballte euron me një rrezik tepër të madh; por, pa një marrëveshje të tillë do të pasonte brishtësia financiare. Problemi do të përkeqësohej nga fakti që Banka Qendrore Europiane nuk do të mund të mernte përgjegjësi për drejtimin e institucioneve financiare të vendeve të euroizuara.

*Pas euroizimit të njëanshëm, Bankës Kombëtare të Shqipërisë nuk do t'i kishin mbetur më rezerva të sajat për të marrë përsipër rolin e huadhënësit të fundit; vërtet që duket të mos ketë një dispozitë ligjore që ta detyrojë bankën ta përmbushë atë rol, por në praktikë kjo zgjedhje tani është e hapur për bankën, dhe humbja e një mundësie të tillë do të ishte katastrofike në rast të një krize financiare.*

*(iv) Humbja e politikës kombëtare monetare.* Çdo regjim kursi këmbimi i pandryshueshëm, kufizon mundësitë për politikë të brendshme monetare. Hyrja e përhershme në një monedhë të përbashkët, e çfarëdolloj forme, ia kalon politikën monetare bankës qendrore, përgjegjëse për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Sigurisht që nevojat për stabilitet të vendeve në tranzicion mund të mos lejojnë shumë vend për një politikë autonome monetare, por rënia e menjëhershme e inflacionit mund të mos jetë politika më e mirë, siç vërtetohet nga suksesi dominues i ekonomisë polake, e cila pavarësisht gjithë diskutimeve për terapinë e *shock*-ut, ka dhjetë vjet që ecën me një hap gradual torturues. Për më tepër, të gjitha ekonomitë në tranzicion të Europës Qendrore e Lindore po përballen me sfida tepër të mëdha përsa i përket çështjeve të reformave të ndihmës sociale, më të mëdha sesa pjesa tjetër e Europës (shih Eatwell et al., 2000) të cilat mund të ngrenë nevojën për administrimin makroekonomik specifik për secilin vend.

Politika e ndjekur nga banka qendrore mund të mos përputhet me parimet bazë të vendeve të euroizuara. Mundësia e lëkundjeve asimetrike brenda Bashkimit Monetar European është reduktuar nga zbatimi i kriterëve të Maastrichtit dhe nga i ashtuquajtimi pakt “i stabilitetit dhe rritjes”, por nuk mund të eliminohet. Vendet e euroizuara që nuk janë anëtare në Bashkimin Monetar European do të jenë më të prirura të vuajnë lëkundjet asimetrike.

**Humbja e një politike monetare të brendshme, si rezultat i euroizimit është i qartë, po nuk duhet ekzagjeruar. Një regjim kursesh i drejtuar mund të mos jetë në gjendje të drejtojë çdo**

politikë monetare, por është ende tërësisht “i pavarur” në lidhje me autoritetet politike. Mbasi qeveria i ka deleguar një bankë qendrore, tërësisht të pavarur, mbajtjen e stabilitetit të çmimeve, gjithashtu, ajo ka hequr dorë nga sovraniteti i saj monetar. Më pas, ka pak rëndësi nëse është një bankë qendrore kombëtare ose një bankë që ka vetëm një qëllim, të njëjtë, dhe e pavarur superkombëtare ose bankë e huaj qendrore, ajo që administron përdorimin e monedhës.

(v) *Monedha në të cilën është dhënë borxhi i jashtëm.* Borxhi i jashtëm mund të shprehet në monedha të tjera përveç euros, veçanërisht në dollarë. Një numër vendesh në tranzicion kanë rritur një pjesë të madhe të borxhit të tyre të jashtëm në dollarë amerikanë: në vitin 1997, përpjesa që zinte borxhi i jashtëm i emetuar në dollarë ishte 77.9 për qind në Republikën Çeke, 75.1 për qind në Bullgari, 61.6 për qind në Lituani, 46 për qind në Poloni, kundrejt përpjesës të markave gjermane përkatësisht prej 4.7 për qind, 4.7 për qind, 6.2 për qind, 9.9 për qind (DBR,2000). Për vende të tilla çdo nënçmim i euros në lidhje me dollarin, ashtu sikurse ndodhi në tetëmbëdhjetë muajt e parë të jetës së euros në vitin 1999-2000, do të rrisë pengesat e brendshme të shërbimit të borxhit të huaj; një ridominim domethënës i borxhit të jashtëm do të duhet të shoqërojë euroizimin ose kompensimet e transaksioneve në këmbimet e huaja në drejtim të tregjeve duhet të futen në një shkallë të gjerë. Në Shqipëri, pjesa më e madhe e borxhit publik është i brendshëm (42 për qind e PBB-së) dhe borxhi i huaj, që zë 27 për qind të PBB-së, është relativisht i vogël. Ky do të jetë relativisht një problem i vogël, jo i vështirë për t'u arritur, megjithatë duhen ndërmarrë veprime dhe, rrjedhimisht, do të shkaktohet një kosto.

(vi) *Praktikat e faturimit.* Në disa vende, ku bën pjesë edhe Shqipëria (shih seksionin 2 më sipër), euro mund të mos jetë monedha e preferuar në tregun e jashtëm në praktikën e faturimit, e cila mund të jetë vështirë për t'u ndryshuar. Praktikrat e rregullimit janë konsideruar shpesh si të rëndësishme, por ato janë jo të qenësishme. Për shembull, Helmut Aancans, drejtor i politikës monetare në Bankën Qendrore të Letonisë, ka cituar duke thënë që: Struktura jonë e rregullimit të monedhës reflekton shportën e SDR-së . . . Kur euro bie, dollari ngrihet dhe nuk ka mosstabilitet rrjeti (Financial Times 16 Shkurt 2000). Por, një stabilitet i tillë përfiton vetëm nëse SDR-ja është monedha në të cilën janë të shprehura marrëveshjet. Lita lituaneze, e lidhur me kurs fiks ndaj dollarit amerikan, ndërkohë, vlerësohej në terma realë kundrejt monedhave të tjera, të përdorura në vendosjen e çmimeve dhe në

faturim, duke shkaktuar kështu një nivel të lartë të deficitit në llogarinë korente.

“Tregtia në euro nuk është aq e madhe sa tregtia në dollarë” (Zëvendësguvernatori i Bankës Qendrore, Arvidas Krejzde, po aty) por, 40 për qind e tregtisë së jashtme letoneze është me Bashkimin Europian dhe vlerësimi ishte, për këtë arsye, një problem i paneglizhueshëm. Në Shqipëri, roli dominues i dollarit amerikan në faturimin dhe rregullimin madje edhe në tregtinë me Bashkimin Europian, është pa dyshim një pengesë madhore për euroizimin – e njëanshëm ose madje dhe gjatë anëtarësimit eventual në Bashkimin Monetar Europian. *Praktikat e faturimit duhet të ndryshojnë para kësaj ose euroizimi do të duhet të shtyhet ose të zëvendësohet nga një bord monedhë e tipit lidhje midis të dyjave, euros dhe dollarit.*

(vii) *Impakti inflacionist i rivlerësimit të vërtetë.* Të gjitha ekonomitë e tranzicionit kanë paraqitur konvertueshmërinë në një kurs këmbimi domethënës të nënvlerësuar; qëndrueshmërisht të gjithë kanë nënshkruar rivlerësimin e vërtetë duke rënë gradualisht drejt një pozicioni rreth dyfishit të raportit midis kursit të këmbimit në kushtet e paritetit të fuqisë blerëse dhe kursit aktual.

Rivlerësimi real është përgjithësisht i shoqëruar me të ashtuquajturin efekt të Harrod–Balassa–Samuelson, të rendimentit më të shpejtë në sektorët e tregtueshëm duke rritur pagat dhe çmimet në sektorët e patregtueshëm (shih Coricelli 2001), por ky efekt mund të mbulohet lehtësisht. Së pari, kjo duhet të jetë një tendencë mbarëbotërore, që reflekton në ndryshimet e çmimeve, një rritje më të madhe të diferencuar për rendimentin në sektorin e tregtueshëm në krahasim me atë të patregtueshëm. Kjo mund të jetë pozitive për ekonomitë në tranzicion duke arritur teknikat e praktikave më të mira (Buitier, 2001), por jo aq të larta sa ndryshimet e brendshme në produktivitet ndërmjet të dy sektorëve. Së dyti, mallrat e tregtueshëm përdoren jo vetëm si inpute në mallrat e patregtueshëm, por edhe si zëvendësues për to, të cilat reduktojnë disi rëndësinë e klasifikimit. Pavarësisht nga ky efekt ose në plotësim të tij, çdo kurs këmbimi (fiks ose i ndryshueshëm) në të cilin konvertimi është prenzatuar në një kohë inflacioniste dhe të turbullt, në terma realë duhet të mos merret parasysh. Si pasojë, për çdo regjim të kurseve fikse në vlera nominale, rivlerësimi real i nevojshëm, i pashmangshëm, do të përfshijë ndryshime pozitive të inflacionit duke iu përmbajtur regjimit të kurseve fikse. Duke përjashtuar asistencën e kontrollit mbi inflacionin, në kushte të tilla, çdo regjim kursesh këmbimi fikse mund

të kthehet në një makinë të pamëshirshme të prodhimit të inflacionit. Rivlerësimet e nevojshme reale, mund të arrihen vetëm pa inflacion nëpërmjet një rivlerësimi nominal, i cili është dhe rruga e përvojës në Shqipëri, e vetme gjatë gjithë ekonomive të tranzicionit (shih seksionin 2 më sipër). *Euroizimi i njëanshëm do të eliminonte për Shqipërinë mundësinë për të vazhduar një proces të tillë rivlerësimi real joinflacionist.*

Sigurisht një rivlerësim real mund të jetë jo në harmoni me angazhimet paralele të stabilitetit të çmimeve dhe të kursit nominal të këmbimit, të përfshirë nga kriteret e Maastrichtit (Rollo 2001), dhe eurozimi i njëanshëm mund të shihet (Bratkowski dhe Rostowski, 2000) si një rrugë për të shmangur ato detyrime. Megjithatë, një luhatje e gjerë e marzheve të parashikuara nga ERM II (+/- 15 për qind e pariteteve qendrore) dhe zbatueshmëria e limiteve të inflacionit të Maastrichtit vetëm në rrugën për anëtarësim në EMU – për një ekzaminim para një viti – duhet ende të lejojë kandidatët e EMU-së, të akomodojnë rivlerësimet reale të nevojshme pa ju dashur të euroizojnë arbitrarisht. Pas anëtarësimit në EMU ata mund –si dhe Irlanda - të vazhdojnë ta mbajnë inflacionin sipas kushteve, vetëm se do të jenë subjekte të detyrimeve fiskale.

#### **KONVERGENCA DREJT FUSHËS OPTIMALE TË MONEDHËS**

De Grauwe dhe Askoy (1997, shih gjithashtu, de Grauwe dhe Lavra 1997) diskutuan që vendet e Europës Qendrore dhe Lindore nuk janë pjesë e një zone optimale të monedhës europiane (ZOM), siç është përmendur nga Mundell në artikullin e tij në vitin 1961, domethënë si një rajon disi homogjen me cikle të sinkronizuara dhe reagime simetrike, çmime fleksible dhe faktorë të lëvizshëm. Gligorov (2001) e thekson më fort duke diskutuar se asnjë vend i Ballkanit-duke përfshirë edhe Shqipërinë – nuk përbën një zonë optimale të monedhës në vetvetë, duke lënë veç bashkueshmërinë me vendet e tjera të Ballkanit ose me Bashkimin Europian. McKinnon (2001) përmend kontributin, pak të njohur, të Mundell-it (1971) në literaturën e ZOM, ku në veprën e tij ai thekson avantazhet e disa ndryshimeve për përmirësimin e diversifikimit të rrezikut brenda zonës. Për me tepër, u sugjerua që hallkat e ngushta të tregtisë, aktualisht, mund të promovojnë konvergjencë ekonomike, në këtë mënyrë krijojnë kriteret e ZOM-it endogjene (Frankel dhe Rose, 1997 dhe 1998).

Diskutohet, që diversiteti i ekspozuar nga ekonomitë në tranzicion, në vitin 1990, tejkalon shkallën e diversitetit që aktualisht mund të

jetë e mirë për një ZOM, dhe i cili mund të vendosë në mocion konvergjenca të brendshme.

Nuk ka dyshim, që kostot e diskutuara në seksionin e mëparshëm do të jenë, në mënyrë të konsiderueshme, të reduktuara me konvergjencën e ekonomive në tranzicion me euron; përfitimet, gjithashtu, mund të reduktohen, por proporcionalisht më pak se kostot. Konvergjenca mund të kuptohet jo vetëm për parametrat monetarë dhe fiskalë, por gjithashtu, edhe për parametrat realë dhe institucionalë.

(i) Konvergjenca monetare dhe fiskale, sikurse janë prezantuar dhe në kriteret e Maastricht, kanë tërhequr shumë vëmendje. Ideja kryesore është se konvergjenca mund të realizohet jo drejtpërdrejt, nëpërmjet lidhjeve me tregtinë, por si një rrjedhim i përmasave të një politike të matur. Në të vërtetë, shumë prej kandidatëve për t'u pranuar, shfaqin progrese të dukshme drejt përmbushjes së këtyre kriterëve, të cilat duken të jenë të mirërealizuara. Në Shqipëri, pjesa që zë borxhi qeveritar ndaj PBB-së është rreth 70 për qind më e lartë se mesatarja prej 50 për qind e ekonomive në tranzicion, por më e ulët se mesatarja e Zonës së Euros, rreth 73 për qind në vitin 2000<sup>11</sup>.

Deficiti qeveritar prej 9 për qind në vitin 2000, megjithëse ka rënë, është tre herë më shumë se maksimumi i lejuar në Traktatin e Maastricht-it, dhe këshilla e Fondit Monetar Ndërkombëtar për financimin e brendshëm të deficitit prej 3.25 për qind, është një vlerë e mirë, por një vetkënaqësi e papranueshme, sepse borxhi total i Shqipërisë ka akoma shumë rrugë të gjatë për të bërë përpara se të arrijë përmasat e borxhit të Belgjikës apo të Italisë. Është e vërtetë që deficiti mund të reduktohet me të vërtetë shpejt, përtej limitit të 3 për qind të PBB-së, nëpërmjet masave drastike, nëse është vullneti politik, por të ardhurat publike janë akoma realisht të ulta, në 22.4 për qind të PBB-së (me shpenzime rreth

---

<sup>11</sup> Parashikimet e FMN-së tregojnë për një reduktim të borxhit të Shqipërisë me 50 për qind. Në kushte makroekonomike të favorshme, por edhe në kushte më të pafavorshme, borxhi publik nuk duhet të jetë një shqetësim i mbartur, i vazhdueshëm. (FMN 2001b, fq.5.)

Borxhi i jashtëm rreth 27- 28 për qind e PBB-së, dhe jo me maturitet afatshkurtër, mund të mirëadministrohet kur ngarkesa e shërbimit të borxhit zë rreth 4.5 për qind të vlerës dhe pritet që të qëndrojë nën 6.25 për qind deri në vitin 2005. Vlera neto aktuale e borxhit të jashtëm, në krahasim me nivelin e eksporteve është 83 për qind. Në vitin 2000, Shqipëria në marrëveshje me Klubin e Parisit arriti riskedulimin e borxhit të Austrisë, Francës, Italisë dhe Holandës; pagesa e plotë iu bë Danimarkës. Një progres më i kufizuar ka qenë në marrëveshjet me Klubin e Londrës për kredituesit tregtarë.

31.4 për qind ) dhe duhet të rriten në Shqipëri, që t'i afrohen niveleve të Bashkimit Europian. Inflacioni shqiptar është brenda objektivave të Maastricht<sup>12</sup>, ndërsa normat e interesit nuk janë në përputhje me këta objektiva.

Shqetësimi është se kriteret e Maastrichtit nuk marrin parasysh karakteristikat esenciale dhe problematike të vendeve në tranzicion, si për shembull, deficitet dhe huatë pothuajse- fiskale, detyrimet ndaj ekstrabuxhetorëve, shpenzimet publike të anuluar dhe/ose të mbartura si dhe angazhimet, duke përfshirë huatë e pakthyer dhe nënzëra të fshehur në bilancet e gjendjes të bankave. Kriteret e Maastricht nuk e përfshijnë pjesën e vogël të kreditimit të sektorit privat, kapitalizimin e ulët dhe/ ose likuiditetin e ulët të tregjeve financiare të vendeve në tranzicion, si dhe paqëndrueshmërinë e jashtëzakonshme të normave të kthyeshmërisë (shiko BERZH,2000). Në qoftë se do të merren parasysh të tilla kritere, pothuajse fiskale, edhe duke ju referuar kandidatëve më dinjitozë, si Republika e Çekisë, do të humbasin shumë nga reputacioni i tyre (shiko Drabek,2000). Pjesa që zë kreditimi i sektorit privat duket të jetë e lidhur, në mënyrë të zhdrejtë, me pjesën e huave të pakthyer në afat (BERZH 1997). Ekonomitë në tranzicion paraqesin ose kapitalizim të ulët të tregut ose normë të ulët të vlerës së tregtueshme në kapitalizimin e tregut (si për shembull, jo likuiditete) të aksioneve të tyre- si për shembull, përkatësisht 2.6 dhe 36.3 për qind të PBB-së në Rumani, 39.7 dhe 3.9 për qind në Rusi- ose të dyja së bashku si për shembull, 5.8 dhe 7.6 për qind në Bullgari dhe 6.2 dhe 11.6 për qind në Letoni (BERZH, 2000). Progrese të mëtejshme, për t'iu përafuar objektivit të inflacionit të Maastricht-it, mund të jenë të kushtueshme<sup>13</sup>. Shqipëria është në një pozicion të përzier. Ristrukturimi bankar ka filluar, dhe gjithashtu, ka ndikuar në rritjen e borxhit publik nga 63 për qind në 69 për qind të PBB-së. Megjithatë, reforma e pensionit është e nevojshme për shkak të paqëndrueshmërisë të një sistemi ku shkalla e varësisë (kontribues/ përfitues), nëpërmjet moshës, papunësisë dhe

---

<sup>12</sup> Rother (2000) gjeti që ka një rregullim relativ të çmimeve, i cili imponon një prirje rritëse në inflacionin në Shqipëri, në veçanti për shkak të një inelasticiteti të ulët. Në këto kushte, politika monetare duhet të lejojë disa inflacione pozitive, meqenëse disa faktorë, që shkaktojnë rritjen e inflacionit prezantojnë një rregullim ekuilibri ndaj të cilit nuk duhet bërë rezistencë. Nuk përjashtohet mundësia që prirje të tilla inflacioniste të mund të shfaqen dhe në të ardhmen.

<sup>13</sup> Në tetor 2001 në Varshavë, zëvendësguvernatori i BQE Christian Noyer tha: "Vendet e Europës Qendrore dhe Lindore nuk duhet të përpiqen të përmirësohen (kualifikohen) për anëtarësimin në Eurozonë, duke ushtruar presion mbi inflacionin me një shpejtësi të tillë, sa ata të pengojnë rritjen e të ardhurave reale të popullsisë. (Financial Time, 16 tetor.)"

evazionit, ra nga 4.5 që ishte në vitin 1993 në 0.8 në vitin 1999 (më pas një rritje në 0.9 në vitin 2000 nëpërmjet rritjes së kontribuesve; shih Treichel 2001). Në të njëjtën kohë, tregjet financiare në Shqipëri janë shumë të pazhvilluara, me një treg sekondar inekzistent të letrave me vlerë të qeverisë, me një pjesëmarrje të madhe të bankave në tregun primar si dhe me një bursë që akoma është në hapat e saj të parë.

(ii) Konvergjenca reale, nga pikëpamja e disa vëzhguesve, nuk është koncept domethënës (Gros 2000), por në të kundërtën mund të identifikohet lehtësisht si një konvergjencë e të ardhurave reale për frymë – një proces i “*caching up*” (avancimi drejt) i cili tashmë është quajtur “konvergjenca reale”, nga raporti i nëntorit 2000 të ECOFIN (fq.2)- dhe për këtë, të produktivitetit të punës dhe nivelit të pagave; të normave reale të interesave, normës së papunësisë, kapacitetit e dobishmërisë. Kandidatët për t’u pranuar kanë një të ardhur për frymë, që varion nga 7 për qind e mesatares së Bashkimit Europian, si në Bullgari, rreth 50 për qind në Slloveni; edhe pse në kurset e këmbimit të PPP-së (Pariteti i Fuqisë Blerëse) këto diferenca janë më të ulta, respektivisht rreth 23 për qind dhe 70 për qind, përsëri ato mbeten të larta (EC-DG II,2001). Shqipëria është akoma disa hapa mbrapa, jo vetëm në të ardhurat për frymë, por më shqetësuese, në konvergjenca strukturore, duke patur një strukturë të të punësuarve në industri prej 11.5 për qind, në bujqësi prej 51 për qind, në ndërtim prej 14.8 për qind, në transport prej 3.5 për qind, në shërbime të tjera prej 19.2 për qind. Me diferenca të qëndrueshme në të ardhurat për frymë, kostoja e politikave të kohezionit (nëpërmjet fondeve strukturore dhe transfertave të tjera) është e detyruar të jetë e lartë dhe nuk është e qartë nëse mund të mbahet brenda limiteve aktuale të Bashkimit Europian, 4 për qind të PBB-së të vendit përfitues.

Të tilla politika rishpërndarjeje duhet të intensifikohen më tej, në qoftë se Bashkimi Europian mbështet fermerët vendas, përpjesa e të cilëve në punësim dhe PBB, në vendet që kandidojnë për pranim, paraqet shumëllojshmëri ekstreme në të dyja rastet, si brenda grupit të anëtarëve të rinj dhe atyre që i përkasin bashkimit të 15 vendeve. Normat e rritjes janë të detyruara të rriten shumë më shpejt në vendet për pranim të Europës Qendrore dhe Lindore, të cilat janë të angazhuara në procesin e “*caching up*” (kapjes), i cili ndoshta është më shumë inflacionist dhe kërkon një politikë monetare më liberale, se sa ajo që i përshtatet Eurozonës aktuale prej 12 vendesh. Disa prej tyre, si për shembull konvergjenca e vazhdueshme të nivelit mesatar të papunësisë të Bashkimit Europian dhe variancat- nuk janë kërkuar nga ndonjë traktat, por

ato janë arritur shpejt, që në fillimet e vitit 1990- ndërkohë që konvergjenca reale duken të jenë shumë të ngadalta dhe në një proces më të stërzgatur se sa ai i parashikuar (shih Kolodko, 2000; shih gjithashtu Salvatore, 2000).

iii) Konvergjenca institucionale, gjithashtu, kanë bërë përpertime të shpejta, së paku për vendet që ndodhen në rradhët e para për pranim, duke gjykuar nga vlerësimet e BERZH-it, për arritjet sistematike në tranzicion, në tabelën e rezultateve të publikuar çdo vit, që nga viti 1994 në raportin e tij të tranzicionit. Në veçanti, në fusha të tilla si privatizimi dhe tregtia me të huajt, rezultatet e tranzicionit janë impresionuese, edhe për Shqipërinë (shih tabelën 1 për një krahasim më vende të tjera të Ballkanit, si Rumania dhe Bullgaria si dhe me kandidatët e parë për pranim në Bashkimin Europian, Polonia dhe Hungaria). Sidoqoftë, treguesit e BERZH-it vuajnë nga një tendencë më shumë se sa optimiste, së paku për shkak të përshtatjes së rezultateve duke i renditur nga 1 tek 4+, në vend që të fillojë nga zero. Kjo favorizon dhe vendet në tranzicion, të cilat akoma nuk kanë filluar, me një realizim mbi 20 për qind të rrugës për një vendosje të plotë të ekonomisë së tregut (shih Nuti 2001). Për më tepër, përafrimet e BERZH-it neglizhojnë çdo nocion të minimumit të kërkuar për një vend, që të operojë si një ekonomi tregu ose e peshave ponderuese të mundshme që mund t'iu bashkëngjiten treguesve të tyre të ndryshëm, ose të vështirësisë relative për të ecur përpara në momente të ndryshme të evolimit (zhvillimit) dhe në fusha të ndryshme. Në veçanti, sistemi bankar, tregjet financiare dhe regjimet rregullatore nuk janë akoma të zhvilluara në mënyrë të mjaftueshme, për një arsye të drejtë se ata duhet të vendosen si *ex novo* (që nga fillimi) dhe jo të ristrukturohen sikurse po ndodh me sektorët e tjerë prodhues.

Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (2001b): “Përveç përmirësimeve të viteve të fundit, ekonomia shqiptare vazhdon të përballet me një dobësi institucionale dhe në infrastrukturë, duke patur, në mënyrë të theksuar, nevojën e një programi të reformave strukturore”. Kujtimet e rënies së firmave piramidale në vitin 1997- në një nivel sa gjysma e PBB-së së vitit- janë akoma duke u tërhequr zvarrë. Kjo u shkaktua në rradhë të parë, nga pamjaftueshmëria e sistemit financiar formal, me bankat shtetërore që dështuan në rolin e tyre si ndërmjetës të kursimeve dhe bankat private të ngadalta në shfaqjen e tyre si dhe nga nxitja, kryesisht të financave tregtare se sa të thithjes së depozitave. Autoritetet e trajtuan mirë problemin edhe pse reagueshan me vonë (Jarvis 2000).

Lidhjet ekonomike ndërmjet ekonomive të tregjeve të zhvilluara si për shembull, Bashkimin European –15 dhe ekonomive me një sistem tregu të pakompletuar, janë të ngjashme me sistemet e mëparshme të tipit sovjetik, planifikim i centralizuar; ato mund të shfaqen- dhe në një nivel mikroekonomik ato mund të jenë- me përparësi të shumta, por nuk janë një themel i mirë për një ekonomi eficiente dhe integrim monetar.

Këto konsiderata kërkojnë përkujdesje më të madhe në vlerësimin e progresit të konvergencës së anëtarëve të rinj drejt standardeve unike të Bashkimit European- dhe për këtë arsye, duke vlerësuar përparësitë bruto dhe neto që do të përfitohen nga të dyja rastet: anëtarësimi i tyre në Bashkimin Monetar European dhe nga zëvendësimi i mundshëm i monedhës.

Harbis (2001) thekson se, në baza krahasuese, rasti i vendosjes së një monedhe unifikuese është i dobët në Republikën e Çekisë dhe në Hungari. Edhe sepse ato konvergojnë, ato nuk kanë nevojë të importojnë stabilitet dhe kredibilitet monetar, nuk janë shumë të euroizuara dhe nuk do të fitojnë një reduktim domethënës në nivelin e rrezikut. Në Poloni, si një ekonomi mesatarisht e mbyllur, një politikë monetare autonome mund të zbusë ciklet ekonomike; por vendi mund të fitojë një reduktim në normat e interesit dhe në nivelin e rrezikut duke zëvendësuar monedhën vendase nga euro-për aq kohë sa të jenë zgjidhur formalitetet e tregut të punës. Bullgaria paraqet të gjitha kushtet favorizuese për një adoptim të hershëm të euros (tek Roussonova 2001 ka shumë më tepër kujdes në vlerësimin e saj). Një rast i fortë për euroizim është shkruajtur, gjithashtu nga Sulling (2001), për rastin e Estonisë. Parimisht, zhvendosja nga bord monedha drejt zëvendësimit të monedhës është më pak traumatike se sa një zhvendosje e njëjtë, që fillon nga një lloj tjetër regjimi i kurseve të këmbimit.

#### **POLITIKAT E BASHKIMIT EUROPIAN DHE BANKA QENDRORE EUROPIANE DREJT EUROIZIMIT TË NJËANSHËM**

Si Komiteti European dhe Banka Qendrore Europiane, i kanë lejuar vendet candidate për pranim, të adoptojnë çdo regjim kursesh këmbimi që ato vetë mund të zgjedhin, duke përfshirë dhe bord monedhë, siç është miratuar dhe nga pranimet e tyre në Bullgari, Estoni dhe Lituani. Disa kohë pas pranimet, do të pritet që shtetet e reja anëtare të bashkohen me ERM II, i cili është i papajtueshëm me regjimin e plotë luhatës të kurseve të këmbimit, dhe me atë të fiksuarin (plotësisht ose pjesërisht i fiksuar) kundrejt një reference ndaj monedhave të tjera të ndryshme nga euro. Por, euroizimi në një këndvështrim të ngushtë, i kuptuar si zëvendësimi i monedhës

vendase me euron, në të kundërtën është rregulluar plotësisht në mënyrë strikte nga Bashkimi European derisa janë përcaktuar jo vetëm konvergjenca për hyrjen, por dhe për pranimin e negociuar në Bashkimin Monetar European:

“Çdo adoptim i njëanshëm i monedhës së vetme në kuptimin e “euroizimit”, do të jetë në kundërshtim me nënvizimet e arsyeve ekonomike të traktatit të Bashkimit Monetar European, i cili parashikon adoptimin aktual të euros, si një pikë përfundimtare e procesit të strukturuar të konvergjencës brenda një kuadri pune të shumëllojshme. Për këtë arsye, euroizimi i njëanshëm nuk do të jetë një mundësi e anashkalimit të hapave të parashikuar nga traktati për adoptimin e euros”. (EC 2001a,p.21, këshilla të mëtejshme; shih, gjithashtu, një deklaratë të ngjashme në EC-DG-II 2001 dhe në raportin e ECOFIN të Samitit të Nices, në nëntor 2000.)

Për një kritikë të plotë të të dyja këndvështrimeve, si të themeleve ligjore ashtu edhe ekonomike të këtij mospëlqimi, të zëvendësimit të monedhës, i jemi referuar materialit të Nutit (2001). I paraqitur nga një këndvështrim ligjor, Traktati i Maastricht vendos kushtet për anëtarësimin e plotë në Bashkimin Monetar European dhe nuk thotë asgjë për të ndaluar ndonjë joanëtar, është apo jo një kandidat për pranim (ose në të vërtetë as dhe një anëtar i Bashkimit European jo i kualifikuar për anëtarësimin në BME), për të përshtatur euron si monedhën e tij vendase. Duke zëvendësuar monedhën e tij me euron, një vend duhet të braktisë plotësisht marzhin prej 15 për qind të luhatjes, sikurse është skicuar nga ERM-II; si për shembull, një angazhim më i madh në një kurs këmbimi stabil duhet të përgëzohet dhe jo të penalizohet. Nga pikëpamja ekonomike, ky mospëlqim për një euroizim të njëanshëm është ndoshta i ndikuar nga tre konsiderata:

Së pari, frika se pjesëmarrja në Zonën e Euros (edhe pse jo në Bashkimin Monetar European) e vendeve të dobta mund të destabilizojë euron, duke neglizhuar që vendet qendrore të Europës Lindore përfaqësojnë nën 6 për qind të të ardhurave të përgjithshme të Bashkimit dhe 3 për qind të ofertës për para. Një kërcënim i madh- nëse ka ndonjë të tillë- do të ishte më e mundshme të vinte nga euroizimi i njëanshëm, jo i vendeve që janë pranuar për të hyrë, por nga jashtë, i parë në këndvështrimin e nivelit të tyre inferior mbi konvergjenca të parametrave të Bashkimit European.

Së dyti, frika se presioni politik mund të sjellë që Banka Qendrore Europiane të tolerojë, dhe të marrë parasysht nevojat e veçanta të

vendeve të euroizuara, në rast se përjashtojmë se Banka Qendrore Europiane nuk do të jetë e detyruar që të bëjë një gjë të tillë dhe do të qëndrojë plotësisht e pavarur në krijimin e politikave të saj monetare.

Së treti, frika se kurset e këmbimit, në të cilat një vend është i euroizuar në mënyrë të njëanshme, mund të nënçmohen gjerësisht, duke dëmtuar kështu konkurrencën e eksporteve të Bashkimit Europian. Këto shqetësime, nuk janë të justifikuar, në aspektin e (i) nivelit të lartë të deficitit të llogarisë korente, në përgjithësi dhe në veçanti drejt Bashkimit Europian, e të gjithë kandidatëve për pranim dhe në veçanti ata, të cilët kanë përshtatur një bord monedhë, të cilat justifikojnë një element të nënvlerësimit kur është zgjedhur një kurs hyper fiks; dhe (ii) presioni inflacionist në rritje, në ekonomitë që rriten dukshëm më shpejt se sa anëtarët aktualë të Bashkimit Europian, të cilët janë të detyruar të refuzojnë çdo fitim fillestar nga konkurrenca prej zhvlerësimit.

Nuk është e qartë çfarë fitimesh të mundshme mund të përfitohen nga kandidatët, të cilët kanë një bord monedhë, me qëllim që të kënaqin kriteret e Bashkimit Monetar Europian duke iu referuar dokumenteve të Bashkimit Europian për zgjerim (si për shembull, ECOFIN 2000). Së pari, duke u zhvendosur nga kursi i këmbimit fiks që mund ta kenë për një kohë të gjatë, drejt një kursi, që presupozohet më i qëndrueshëm, të rënë dakort me vendet e Bashkimit Monetar Europian. Kjo, duket të jetë skenari i çoroditur, që dëshirohet nga spekulatorët e monedhave, të cilët me të tilla rregulla të lojës mund të arrijnë që të destabilizojnë ekonominë që deri tani është shfaqur si kandidate më e mirë dhe më solide. Një dalje e besueshme nga regjimi i bord monedhës, e lidhur me euron, duket të jetë zëvendësimi në mënyrë të vazhdueshme në kushte të barabarta. Në qoftë se kjo dalje është pritur të bëhet në disa etapa, nuk ka arsye përse të mos lejohet zëvendësimi i monedhës në çdo kohë tjetër, që kandidati për pranim mund të dëshirojë ta bëjë.

#### **KONKLuzionET**

Për Shqipërinë, kostot dhe përfitimet nga euroizimi i njëanshëm janë të lidhura, janë përafërsisht me pritjen më të vogël të përfitimeve nga një zgjerim i konsiderueshëm i tregtisë dhe me koston e një humbjeje të konsiderueshme të *seignorage*. Një kosto e tillë është e detyruar të bjerë në një ulje të vazhdueshme të inflacionit dhe rritje të përpjesës së të ardhurave të qeverisë. Një pengesë e madhe është paraqitur nga një dollarizim jozyrtar mjaft i

përhapur, i cili është një rast i ndryshëm me të dyja situatat, si me euroizimin e njëanshëm dhe me anëtarësimin në Bashkimin Monetar European mbas pranimin. Ndoshta, prezantimi aktual i bankënotave dhe i monedhave të euros (që nga 01.01.2002) do të kthejë në kah të kundërt dollarizimin. Pa e zhvendosur ekonominë nga dollari, i vetmi regjim kursesh hyper fiks, që mund të prezantohet në Shqipëri, është bord monedhë i lidhur me një shportë euro/dollarë, i cili do të sigurojë të gjitha përparësitë që priten nga një regjim kursesh fikse, por jo ato të një monedhe të vetme. Euroizimi i njëanshëm në formën e zëvendësimit zyrtar të plotë, për momentin, nuk është në kompetencat e autoriteteve të Bashkimin European dhe BANKA QENDRORE EUROPIANE, por Shqipëria, si të gjitha vendet e tjera në tranzicion duke përfshirë edhe vendet kandidate për pranim, duhet të ketë situatë të favorshme për të negociuar pranimin e saj.

#### REFERENCAT

BERG Andrew and Eduardo BORENSZTEEN (2000), "The Pros and Cons of Full Dollarisation", Matriale Pune të Fondi Monetar Ndërkombëtar, WP/00/50.

BEVAN Alan A. and Saul ESTRIN (2001), "The determinants of foreign direct investment in transition economies", CNEM-LBS, Londër.

BLEJER Mario I. and Marko SKREB (Eds., 1999), *Bilanci i Pagesave, Kursi i Këmbimit dhe Konkurenca në Ekonomite në Tranzicion*, Kluwer Academic Publishers, Boston/Dortrecht/Londër.

BRATKOWSKI Andrzej and Jacek ROSTOWSKI (2000), "Unilateral adoption of the euro by EU applicant countries: the macroeconomic aspects", Konferenca e 6-të e Dubrovnikut, 29-30 Qershor.

CALVO Guillermo (2001), "On dollarisation", Materiale të Konferencës, Universiteti i Maryland.

CEPS (1999), "A system for post-war South-East Europe", Dokumente pune Nr. 131, Bruksel.

CORICELLI Fabrizio (2001), "Exchange arrangements in the transition to EMU", Materiale të Konferencës, CNEM-LBS, Mars.

DAVIDDI Renzo (1999), "'Hyper-fixed' exchange rate regimes and transition", DG-II, Komisioni Europian, Bruksel.

DE GRAUWE Paul and V. LAVRA (Eds, 1997), *Përfshirja e vendeve të Europës qendrore në Bashkimin Monetar Europian*, Leuven.

DE GRAUWE Paul and Y. AKSOY (1997), "Are Central European countries part of the European Optimum Currency Area?", Materiale të Konferencës, Ljubjanë.

Kërkime të Deutsche Bank (2000), *Vëzhgime mbi euron*, n. 80 dhe 88.

DRABEK Zdenek (2000), "Are even balanced budgets sustainable", Materiale të Konferencës ASSA, Boston, Janar.

EATWELL John, Michael ELLMAN, Mats KARLSSON, Mario NUTI and Judith SHAPIRO (2000), *Vendime të vështira, vende të brishta: politika të mirëqenies sociale në tranzicion*, IPPR, Londër.

BERZH (2000), *Raporti i Tranzicionit azhornuar*, Londër, Maj.

BERZH- Banka Europiane për Rikonstruktim dhe Zhvillim (1994-2001), *Raport i Tranzicionit*, botime vjetore, Londër.

EC-DG II (2001), "Enlargement Argumentaire", *Materiale plotësuese*, n.5, Shtator.

ECOFIN (2000), Report to the European Council in Nice on Exchange Rate Aspects of the Enlargement, in *Ekonominë Europiane*, n.1, Shkurt 2001, EC-DG-II, pp. 1-3.

FEIGE Edgar L., M. FAULEND, V. SONJE and V. SOSIC, "Unofficial dollarisation and currency substitution revisited", Konferenca e 6-të e Dubrovnikut, 29-30 Qershor 2000.

FIDRMUC Jarko (2001), "The endogeneity of Optimum Currency Area criteria, Intraindustry trade and EMU enlargement", Materiale për diskutim të BOFIT n. 8, Helsinki.

Financial Times (The), "Baltic states knock on gates of eurozone", 16 Shkurt 2000.

FISHER Stanley (2001), "Exchange rate regimes: is the bipolar view correct?", Fondi Monetar Ndërkombëtar, Uashington, Janar.

FRANKEL Jeffrey A., and Andreë K. ROSE (1997), "Is EMU more justifiable ex post than ex ante?", *Vështrime të Ekonomisë Europiane* 41, pp. 753-760.

FRANKEL Jeffrey A., and Andrew K. ROSE (1997), "The endogeneity of the Optimum Currency Area Criteria", *Gazeta Ekonomike*, 108, Korrik, pp. 1009-1025.

GLIGOROV Vladimir (2001), "Euro in the Balkans", WIIW, Vienë.

GROS Daniel (1999), "An Economic System for Post War South East Europe", materiale shoqëruese e CEPS ED Nr. 131, Brussels.

GROS Daniel (2001), "The Euro for the Balkans?", Materiale të Konferencës, CNEM-LBS, Mars, Londër.

HABIB Maurizio M. (2001), "Is there a case for unilateral euroisation? Evidence from Bulgaria, the Czech Republic and Poland", CNEM-LBS, *Seria e Materialeve për Diskutim* nr. 19, Londër, Qershor.

HOUSMANN Ricardo (1999), "Should there be Five Currencies or One Hundred and Five", *Politika e Jashtme*, Rast.

HOUSMANN Ricardo, Ugo PANIZZA and Ernesto STEIN (2000), "Why do countries float the way they float?", Inter-American Development Bank-BID, *Materiale pune* #418, Uashington, Maj.

Fondi Monetar Ndërkombëtar (1999), "Monetary policy in dollarised economies", *Material i rastësishëm* n. 171, Uashington.

Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore (1999), "The economic consequences of the Kosovo crisis", Uashington.

FMN (2001a), "Albania: 2001 Article IV Consultation and Review under the PRGF", *Raport për vendin* nr 01/117, Korrik.

FMN (2001b), "Albania: Selected Issues and Statistical Appendix", *Raport për vendin* nr 01/118, Korrik.

JARVIS Chris (2000), "The rise and fall of the pyramid schemes in Albania", *Materiale të punonjsve të Fondi Monetar Ndërkombëtar* vol. 47, nr 1.

KENEN Peter (2000), "Currency Areas, Policy Domains and the Institutionalisation of Fixed Exchange Rates", mimeo, Princeton.

KOLODKO Grzegorz W. (2000), "Globalisation and catching-up: From recession to growth in transition economies", *Materiale pune të Fondi Monetar Ndërkombëtar-së* n. 100, Uashington.

KORHONEN Iikka (1996), "Dollarisation in Lithuania", *Vështrime mbi ekonomitë në tranzicion* 5/96, Banka e Finlandës, Helsinki.

KORHONEN Iikka (1999) "Some implications of EU membership on Baltic monetary and exchange rate policies". BOFIT Online 6/99; *Një përfrim i një materiali pune* prej Qendrës Robert Schuman, Instituti i Universiteteve Europiane, Firence.

KORHONEN Iikka (2000), "Currency Boards in the Baltic countries: What have we learned?", *Ekonomitë Post-Komuniste*, Vol. 12, n. 1, Mars.

LARRAIN and VELASCO (2001), "How should emerging economies float their currencies?", *Materiale Konferencë*, LBS, Mars.

LARRAIN Felipe and Jeffrey SACHS, (1999), "Why Dollarisation is More Straitjacket than Salvation", *Politika të jashtme*, Rast.

McKINNON Ron (2001), "Optimum Currency Areas and the European Experience", *Material Konferencë*, CNEM-LBS, Tetor.

- MUNDELL Robert A. (1961), "A Theory of Optimum Currency Areas", *Vështrime mbi ekonominë amerikane*, LI, n.4, Nëntor, pp. 509-517.
- MUNDELL Robert A. (1973), "Uncommon arguments for common currencies", in H.G. Johnson dhe A.K. Swoboda, *Makroekonomia e monedhave të thjeshta*, Allen dhe Unwin, pp.114-32.
- MUNDELL Robert A. (1998), "Exchange rate arrangements in transition economies", *Materiale të Konferencës së Dubrovnikut*, qershor 1998, në Blejer and Skreb, 1999, pp. 95-130.
- MUNDELL Robert A. (2000), "Currency Areas, Volatility and Intervention", *Gazeta e modeleve ekonomike*.
- NUTI D.M. (2001), "Costs and benefits of euroisation in Central Eastern Europe", *Materiale të Konferencës, CNEM/LBS, Londër*
- OECD (2000), *Vendet e Baltikut: një vlerësim ekonomik i rajonit*, Analizë Ekonomike, Shkurt, Paris.
- PERSOON Thorsten (2001), "Currency unions and trade: how large is the treatment effect?", *Politikat Ekonomike* n. 33, Tetor, pp. 433-448.
- ROLLO Jim (2001), "EMU and the candidates", *Materiale të seminarit të FCO-s*, Nëntor.
- ROSE Andrew K. (2000), "Currency Unions: their dramatic effect on trade", *Politikat Ekonomike* n. 30, Prill, pp. 7-45.
- ROSE Andrew K. (2001), "Currency unions and trade: the effect is large", *Politikat Ekonomike* n. 33, pp. 449-457.
- ROTHER Philipp C. (2000), "Inflation in Albania", *Material pune i Fondi Monetar Ndërkombëtar-së*, WP/00/207.
- ROUSSENOVA Lena (2001), "The Bulgarian Currency Board", CNEM-LBS, *Materiale Konferencë*, Londër, Mars.
- SALVATORE Dominick (2000), "Narrowing the structural gap in Transition Economies", *Materiale Konferencë*, Ministri Austriak i Ekonomisë, Vienë, Qershor.

SCHOBERT Franzisca (2001), "Seigniorage: an argument for a national currency?", mimeo, Universiteti i Frankfurtit.

SEITZ F. (1995), "The circulation of Deutsche Mark Abroad", *Materiale për Diskutim* 1/95, Deutsche Bundesbank, Grupi i Kërkimeve Ekonomike.

STIX Helmut (2001), "Survey results about foreign currency holdings in five central and eastern European countries", forthcoming in *CESifo Forum*, OeNB, Vienë.

TREICHEL Volker (2001), Financial sustainability and reform: options for the Albanian Pension Fund, *Materiale pune i Fondi Monetar Ndërkombëtar-s* WP/01/47.

US-Senate Joint Economic Committee (1999), *Inkurajimi i dollarizimit zyrtar në tregjet emergjente*, Uashington, Prill.

VAUGHAN-WHITEHEAD Daniel (1999), Shqipëria në krizë: Rënia e parashikueshme e një ylli që shkëlqente, *Edward Elgar, Cheltenham, UK*.

Tabela 1. Progresi në tranzicion, Raporti i Tranzicion 2001 BERZH.

	Shqipëri	Rumani	Bullgari	Poloni	Çeki
Përpjesa e sektorit privat ndaj PBB-së, mes-2001	75	65	70	75	80
Privatizimi i ndërmarrjeve të vogla	4	4-	4-	4+	4+
Privatizimi i ndërmarrjeve të mëdha	2+	3+	4-	3+	4
Qeverisja dhe ristrukturimi i ndërmarrj.	2	2	2+	3+	3+
Liberalizimi i tregjeve dhe çmimeve të tregtisë	3	3+	3	3+	3
Sistemi tregtar i kurs.k	4+	4	4+	4+	4+
Politika konkurrionale	2-	2+	2+	3	3

Infrastrukturë					
Telekom	3+	3	3	4	4
Energjia elektrike	2+	3	3+	3	3
Hekurudhat	2	4	3	4	2+
Rrugët	2	3	2+	3+	2+
Ujë i pijshëm					
Ujë i papërdorshëm	1	3	3	4	4
Institucionet financiare					
Reforma bankare dhe liberalizimi i nor. të int.	2+	3-	3	3+	4-
Tregjet e letrave me vlerë dhe institucionet financiare jobanka	2-	2	2	4-	3

